



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 915/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Bardh Topalli, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Bardh Topalli, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, me numër ZL.Anr.915/2017 i datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 10.11.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Bardh Topalli, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, me të cilën ka pretenduar se në vendvotimet 2506D, 2526D dhe 2512D votat e tij i janë bartur kandidatëve të tjerë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve në apel gjeti se parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur dëshmi lidhur me pretendimet e parashtruara në apel. Prandaj, apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë apelin e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.915/2017 më datën 12.11.2017



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*